



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË**

---

Numri i lëndës: 2019:218826

Datë: 20.03.2024

Numri i dokumentit: 05481027

**CP.nr.1058/2021**

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm** me gjyqtarin Genc Hasani dhe me bashkëpunëtoren profesionale Valbona Tahiri, në lëndën përmbartimore të kreditorëve P. K., A. R., Sh. Xh., X. M., I. J. S. Q., E. P., S. A., S. Sh., F. S., te gjithë nga M. te cilët i përfaqëson me autorizim avokat Leutrim Ademi me seli ne Mitrovice, ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës-Drejtoria e Arsimit, lidhur me pagesën e borxhit ne baze te dokumentit përmbartimor - Aktgjykimi Cnr. 591/2019, te datës 25.06.2021, të lejuar me aktvendimin për përmbartim CP 1058/21, te datës 09.09.2021, jashtë seance gjyqësore, me datën 20.03.2024 morri këtë:

**A K T V E N D I M**

**PËRFUNDOHET** procedura përmbartimore e udhëhequr sipas shenjës CP 1058/21, me kreditor P. K., A. R., Sh. Xh., X. M., I. J. S. Q., E. P., S. A., S. Sh., F. S. ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës, -Drejtoria e Arsimit”, për shkak të pagesës së tërësishme të borxhit nga debitori.

**A r s y e t i m**

Kreditorët e përmbartimit P. K., A. R., Sh. Xh., X. M., I. J. S. Q., E. P., S. A., S. Sh., F. S., te gjithë nga M. te cilët i përfaqëson me autorizim avokat Leutrim Ademi me seli ne Mitrovice, ka paraqitur propozim për përmbartim në bazë të dokumentit përmbartimor - Aktgjykimi Cnr. 591/19, te datës 25.06.2021.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit të përmbarimit, me aktvendimin CP 1058/21, te datës 09.09.2021, ka lejuar përmbarimin ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës, -Drejtoria e Arsimit”.

Pasi aktvendimi për ekzekutim CP 1058/21, te datës 09.09.2021, është bere i ekzekutueshëm, kreditori nëpërmes përfaqësuesit me autorizim me dt. ... ka njoftuar gjykatën se debitori i përmbarimit e ka përmbushur në tërësi borxhin.

Andaj, borxhi i kërkuar sipas propozimit për përmbarim është përmbushur në tërësi, pasi që debitori ka përmbushur në tërësi obligimin ndaj kreditorit të përmbarimit, gjykata duke u bazuar në nenin 66 paragrafi 4 të LPP-së, në të cilin parashihet se *“Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore”*, vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

**Departamenti i Përgjithshëm**

**CP.nr.1058/2021 më datë 20.03.2024**

**Gjyqtari**

Genc Hasani

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditorë nga dita e pranimit te të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Mitrovicë.